

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.108/2013, “PËR TË HUAJT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon disa ndryshime dhe shtesa në tri fushat kryesore që rregullohen nga ligji nr.108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, konkretisht, në politikën e vizave, në krijimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike *on-line*, në politikën e punësimit të të huajve, në përmirësimin e disa dispozitave të lidhura me lejen e punës dhe punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, në politikën e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë dhe në shkurtimin e afateve për shqyrtimin e lëshimit të lejes së qëndrimit.

Ky projektligj ka si qëllim krijimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike *on-line*, duke synuar zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij lidhur me pamundësinë për të mbuluar shumë vende me misione diplomatike apo poste konsullore, që do të lëshonin vizë hyrëse në territorin e Republikës së Shqipërisë për të huajt që synojnë ta vizitojnë atë.

Kjo procedurë do të ketë efekt direkt në rritjen e numrit të shtetasve të huaj që dëshirojnë të vizitojnë Shqipërinë apo që e shohin Shqipërinë si një mundësi për punësim.

Ndryshimet e propozuara synojnë zbatimin e sistemit të lëshimit të vizës elektronike si për vizat e tipit “C”, ashtu edhe për ato të tipit “D”. Ky implementim do të synojë integrimin e sistemeve operative në të gjitha institucionet përkatëse të ngarkuara me verifikimin e aplikimeve për vizë dhe miratimin e tyre, në funksion të një procedure të thjeshtuar, të përsheptuar, efikase, të sigurt dhe në respekt të standardeve të kërkuara, dhe do të reduktojë ndjeshëm kohën e ofrimit të këtij shërbimi për marrjen e një vize nga shtetasit e huaj.

Gjithashtu, projektligji synon përmirësimin e dispozitave të lidhura me çështjen e punësimit të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, duke qartësuar afatet kohore dhe procedurat për t’u pajisur me leje pune, si dhe duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me vendet e rajonit, është propozuar që të përjashtohen nga detyrimi për pajisje me leje pune

dhe certifikatë regjistrimi pune për shtetasit e vendeve të Ballkanit Perëndimor, dhe, konkretisht, Bosnjë-Herecegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Në fushën e politikave të qëndrimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me afatet e shqyrtimit dhe lëshimit të lejes së qëndrimit, është vlerësuar dhe është propozuar një afat i arsyeshëm, brenda të cilit do të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme, me qëllim realizimin e shqyrtimit e të lëshimit të lejes së qëndrimit për shtetasin e huaj brenda 30 ditëve, nga 60 ditë që është aktualisht në ligjin për të huajt.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, por është në përputhje me parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe planin e saj të veprimit. Hartimi i projektligjit për përafrimin me nenin 24 të Direktivës 2004/38/KE është i parashikuar në PKIE për kapitullin 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr.108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë, dhe siguron lëshimin e vizës nga ana e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit. Në ligj parashikohet se për të aplikuar për vizë aplikuesi duhet të paraqitet personalisht në konsullatë, të paktën kur aplikon për herë të parë. Pas aplikimit për herë të parë, në rast se e ka të pamundur, aplikuesi përjashtohet nga detyrimi i paraqitjes personale për një periudhë prej 59 muajsh nga aplikimi i parë. Duke u bazuar në sa më sipër, është vlerësuar edhe ndërmarrja e kësaj iniciative ligjore, e cila synon rregullimin ligjor për mundësinë e aplikantit për aplikimin për vizë edhe nëpërmjet sistemit elektronik të vizave. Vendi ynë ka përfaqësi diplomatike e konsullore kryesisht në vendet e Evropës, ku shtetasit e tyre nuk kanë nevojë për viza për të hyrë apo punuar në Shqipëri.

Shtetasit e vendeve që kanë nevojë për viza dhe aplikojnë për t’u pajisur me viza janë nga kontinentet e tjera, ku Republika e Shqipërisë ka shumë pak përfaqësi. Praktikisht, kontinenti aziatik, afrikan dhe jugamerikan mbulohen nga një përfaqësi, në të cilën aplikojnë shtetas të ndryshëm nga i gjithë kontinenti ku ndodhet përfaqësia. Kjo e bën procedurën të vështirë dhe jo shumë tërheqëse për

turistët eventuale, por, po ashtu, edhe për ata shtetas që kanë nevojë apo dëshirojnë të aplikojnë për vizë afatgjatë.

Detyrimi për t'u paraqitur në përfaqësi në momentin e marrjes së vizës e bën procesin jo vetëm të kushtueshëm, por shpesh edhe të pamundur. Në këto kushte, kur vendi ynë nuk mund të shtojë ndjeshëm numrin e përfaqësive në kontinentet e tjera, ofrimi i procedurave *on-line* mbetet alternativa e vetme për një shërbim të shpejtë dhe të arsyeshëm.

Bazuar në sa më sipër, është vlerësuar ndërmarrja e kësaj iniciative ligjore, e cila synon rregullimin ligjor për mundësinë që aplikanti për vizat e tipit “C” dhe “D” të mund të aplikojë edhe nëpërmjet sistemit elektronik të vizave, për t'u pajisur me vizë elektronike.

Aplikimi i vizës *on-line*, duke marrë në konsideratë kushtet dhe mundësitë e Republikës së Shqipërisë,:

- do të reduktojë ndjeshëm kohën e marrjes së shërbimit;
- do të krijojë lehtësira për shtetasit e huaj, që aplikojnë për viza;
- do të evitojë koston e prodhimit të vizave sticker;
- do të shkurtojë procedurat dhe dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, pasi gjithçka do të jetë *on-line* dhe e aksesueshme nga të gjitha strukturat për trajtimin e vizave;
- do të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve;
- do të jenë njëlloj të përfshira, si me procedurat e vizës sticker, të gjitha institucionet e shtetit shqiptar përgjegjëse në trajtimin e procedurës së vizës, si: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit si dhe Shërbimi Informativ Shtetëror;
- do të merret dhe aksesohet nga të gjitha institucionet e sipërpërmendura informacioni i nevojshëm për vizën elektronike;
- do të krijojë lehtësi dhe transparencë për të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces.

Integrimi i të gjitha pikave të kalimit kufitar të Republikës së Shqipërisë në këtë proces është një tjetër element shtesë për sigurinë, në zbatimin e lëshimit të vizës elektronike *on-line*. Aplikimi i vizës *on-line* nuk cenon cilësinë e këtij shërbimi dhe viza do të jetë e vlefshme vetëm për territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ndryshimet e propozuara synojnë implementimin e sistemit të lëshimit të vizës *on-line*, i cili synon integrimin e sistemeve operative në të gjitha institucionet përkatëse të ngarkuara me verifikimin e aplikimeve për vizë dhe miratimin e tyre, në funksion të një procedure të thjeshtuar, të përsheptuar,

efikase, të sigurt dhe në respekt të standardeve të kërkuara, dhe do të reduktojë ndjeshëm kohën e ofrimit të këtij shërbimi për marrjen e një vize për të huajt.

Fakti që Republika e Shqipërisë nuk ka misione diplomatike apo poste konsullore në një numër të konsiderueshëm të vendeve që kërkojnë vizë për hyrjen, qëndrimin dhe daljen nga territori i Republikës së Shqipërisë, rritja e interesave kombëtare ekonomike, kryesisht në fushën e turizmit, por edhe më gjerë, argumenton realizimin e lëshimit të vizave elektronike *on-line* për të huajt në Republikën e Shqipërisë.

Me miratimin e formatit të vizës elektronike, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të njoftojë me notë verbale të gjitha shtetet për mundësinë dhe për kriteret e lëshimit të vizës *on-line* dhe do të dërgojë edhe specimenin e vizës elektronike.

Ndryshimet e propozuara në lidhje me dispozitat që rregullojnë lejen e punës së të huajve synojnë të reduktojnë periudhën kohore që duhet për të marrë një leje pune, duke unifikuar dhe reduktuar periudhën kohore që krijon përsëritje të procesit dhe nuk kontribuon në arritjen e qëllimit për të cilën është vendosur si afat. Projektligji qartëson procedurën e përcaktuar në ligj për të punuar në Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar qartë autoritetet përgjegjëse të përfshira dhe rolin e tyre në proces. Gjithashtu, synohet edhe dhënia e të njëjtave përfitimeve për hyrjen në tregun e punës në vend si të shtetasve të BE-së dhe të zonës Shengen, që, aktualisht, janë të parashikuara në ligjin nr.108/2013, të ndryshuar, edhe të anëtarëve të familjeve të tyre, të shtetasve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, konkretisht Bosnjë-Herecegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, në kuadër të situatës në të cilën gjendet vendi ynë, ku si pasojë e fatkeqësisë natyrore janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në banesat e dy prej bashkive më të populluara të vendit, por jo vetëm, është propozuar që punësimi i shtetasve të huaj në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësia natyrore, të përjashtohet nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë. Ky propozim vjen pasi, bazuar në një analizë paraprake të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe fuqisë punëtore në vend, konsiderohet se ka pamjaftueshmëri të fuqisë punëtore për të mundësuar rimëkëmbjen nga fatkeqësia natyrore brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

Ndryshimi i propozuar në lidhje me afatin e shqyrtimit e të lëshimit të lejes së qëndrimit për shtetasin e huaj është bërë pas analizës së kryer për këtë qëllim, duke mbajtur në konsideratë kohën e nevojshme për të kryer verifikimet nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese për të kryer të gjitha verifikimet e nevojshme për shtetasin e huaj, që aplikon për vizë, dhe, nga 60 ditë, që është aktualisht në pikën 3, të nenit 38, bëhet 30 ditë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar” është hartuar në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Në kuadër të vijimit të procesit të përafrimit të legjislacionit të të huajve me *acquis* të BE-së, projektligji synon përafrim të pjesshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht me pikën 1, të nenit 24, të Direktivës 2004/38/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 prill 2004 “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTI

Projektligji përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) nene.

Në nenin 1 është ndryshuar përkufizimi i termit “vizë”, në pikën 32, të nenit 3, të ligjit, duke përfshirë edhe “vizën elektronike”, si formë të autorizimit të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas procedurave të këtij ligji, i cili lejon të huajin të hyjë, të qëndrojë ose të kalojë transit në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 2 është propozuar ndryshimi i pikës 1, të nenit 21, lidhur me lëshimin e vizës së tipit “C”, në formën e një vize pullë ose të printuar në format elektronik, e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.

Në nenin 3 është propozuar ndryshimi i pikës 1, të nenit 22, lidhur me lëshimin e vizës së tipit “D”, në formën e një vize pullë ose të printuar në format elektronik, e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.

Gjitashtu në pikën 5 të këtij neni përcaktohet se pas fjalëve “... vizës pullë ...”, shtohen “... dhe vizës elektronike ...”, me qëllim miratimin me vendim të Këshillit të Ministrave të kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe formatit edhe për vizën elektronike, duke bërë ndryshimet përkatëse në vendimin nr.513, datë 13.6.2013, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e dokumentacionit

për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 4 është propozuar ndryshimi i nenit 24, konkretisht në pikat 1, 4, 5 dhe 6. Në pikën 1, të nenit 24, është propozuar që pas fjalëve “... jashtë vendit ...”, të shtohen fjalët “... ose nëpërmjet sistemit elektronik të vizave ...”, në kuadër të ndryshimeve dhe implementimit të këtij sistemi, për të mundësuar lëshimin e vizës elektronike. Pika 4 është ndryshuar për të parashikuar mënyrën e aplikimit për vizë, që do të bëhet si me paraqitjen personalisht të shtetasit të huaj, ashtu dhe nëpërmjet aplikimit *on-line* në sistemin elektronik të vizave. Pikat 5 dhe 6, janë ndryshuar për t’u harmonizuar me ndryshimet e bëra, konkretisht, pika 5, është shfuqizuar, pasi lidhej me përjashtimin nga detyrimi i paraqitjes personale për raste të veçanta të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa, fjalia e dytë e pikës 6 përcakton detyrimin për t’u paraqitur personalisht, parashikim që në kuadër të ndryshimeve, humbet qëllimin e tij.

Në nenin 5 është propozuar ndryshimi i nenit 25, me qëllim që në këtë nen rregullat e përcaktuara për lëshimin e vizës të përcaktohen si për vizën pullë ashtu dhe për atë elektronike.

Në nenet 6 dhe 7 propozohet që në titullin dhe përmbajtjen e neneve 28 dhe 29 të ligjit nr.108/2013, pas fjalës “... viza/vizës/vizën ...”, të shtohen fjalët “... pullë dhe elektronike ...”, me qëllim që përcaktimet ligjore për anulimin dhe refuzimin e vizës, si dhe rastet e përcaktuara, të vlejnjë si për vizën elektronike, ashtu dhe për vizën pullë.

Në nenin 8 janë propozuar ndryshime në pikën 1, të nenit 38, të ligjit me qëllim qartësimin e afatit brenda të cilit bëhet kërkesë për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, për shkak të problematikave të konstatuara në praktikë, nga strukturat vendore të kufirit dhe migracionit. Ndryshimi i bërë në pikën 3, të nenit 38, lidhet me reduktimin e afatit brenda të cilit autoritetet përgjegjëse të kufirit dhe migracionit shqyrtojnë kërkesën për pajisjen ose ripërtëritjen e lejes së qëndrimit.

Në nenin 9 propozohen ndryshime në nenin 71, të ligjit, ku saktësohen termat në pikën 3, shfuqizohet pika 4, e këtij neni, në të cilën përcaktohet periudha prej 4 javësh e publikimit të vendit të lirë të punës. Në pikën 5, të këtij neni, shkurtohet afati brenda të cilit shqyrtohet kërkesa dhe lëshohet leja e punës, duke zëvendësuar afatin 30-ditor me afatin 10-ditor. Në pikën 9 janë parashikuar kategoritë që përjashtohen nga detyrimi për pajisjen me leje pune apo certifikatë regjistrimi pune, duke shtuar kategoritë e të huajve që gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit dhe të vetëpunësimit, si më poshtë:

- a) Shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen dhe anëtarët e familjes së shtetasve të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;
- b) Shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë - Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut;
- c) Të huajt që punësohen në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore.

Në nenin 10, të projektligjit, është parashikuar që në shkronjën “a”, të nenit 72, të ligjit në fuqi, pas fjalëve “... shtetas të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen ...”, të shtohen fjalët “... dhe anëtarët e familjes së shtetasve të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë ...”. Ky propozim është bërë në përputhje me pikën 1, të nenit 24, të Direktivës 2004/38/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 prill 2004 “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare”, duke ndryshuar Rregulloren (EEC) Nr. 1612/68 Direktiva të dyfishta të Direktivave 64/221/ EEC, 68/360 / EEC, 72/194 / EEC, 73/148 / EEC, 75/34 / EEC, 75/35 / EEC, 90/364 / EEC dhe 93/96 / EEC. Gjithashtu, janë shtuar si kategori e përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune apo certifikatë regjistrimi pune edhe shtetasit e një prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë - Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe të huajt që punësohen në sektorë të ndryshëm me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore.

Sipas shkronjës “a”, të nenit 72, të ligjit, nuk pajisen me leje pune apo me certifikatë regjistrimi pune të huajt që janë shtetas të njërit prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian edhe zonës Shengen, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë të drejtën e punësimit, sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare, sipas legjislacionit shqiptar.

Është ndryshuar afati për qëndrimin e pjesëtarëve të ekuipazheve të anijeve, deri në dy muaj brenda një viti, periudhë gjatë së cilës nuk pajisen me leje pune apo me certifikatë regjistrimi pune. Ky ndryshim është bërë në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare që burojnë nga Konventa e Detit në të cilën ka aderuar Republika e Shqipërisë.

Nisur nga situata që po kalon vendi ynë, ku si pasojë e një fatkeqësisë natyrore, krahas humbjeve në njerëz, janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në ndërtesa banimi në tri qarqe të vendit, ku dhe është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, me qëllim rimëkëmbjen e këtyre qarqeve nga pasojat e fatkeqësisë dhe bazuar në faktin që rimëkëmbja brenda një afati të shkurtër

kohor kërkon angazhimin e burimeve njerëzore shtesë, krahas atyre vendase, në veçanti në sektorin e ndërtimit, por jo vetëm, është menduar që të lehtësohet punësimi i të huajve në sektorë të ndryshëm me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, duke i përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë. Në këtë rast, deklarimi për punësimin e tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor, pranë zyrës së punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti.

Në nenin 11, të projektligjit, janë propozuar ndryshime në nenin 82, të ligjit në fuqi, në lidhje me kuotat vjetore të punësimit të të huajve dhe nevojës së ndryshimit të tyre, në varësi të nevojave të tregut të punës, për punonjës të huaj. Konkretisht, parashikohet që kuotat vjetore për punësimin e të huajve të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për çështjet e migracionit të punës dhe të ministrisë përgjegjëse të sektorit përkatës. Kur nevojat e parashikuara për numrin e punëtorëve të huaj, për një sektor të caktuar, tejkalojnë numrin e përcaktuar në kuotën vjetore, ministri përgjegjës për çështjet e migracionit të punës në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për një sektor të caktuar i propozojnë Këshillit të Ministrave miratimin e kuotave të reja për atë sektor. Kuotat vjetore përcaktohen duke marrë parasysh analizën e nevojave për aftësi në tregun shqiptar të punës dhe projeksionet për zhvillimin ekonomik në sektorë të caktuar, si dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ata sektorë. Procedurat e bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitutional për përcaktimin e kuotave vjetore për punësim miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e migracionit të punës.

Në nenin 12, të projektligjit, është parashikuar ndryshimi i pikave 1, 2 dhe 3, si dhe shfuqizimi i pikës 5, të nenit 84, të ligjit në fuqi.

Konkretisht, përcaktohet se leja e punës për të huajin, si punëmarrës, brenda kuotave vjetore të përcaktuara sipas nenit 82, të ligjit për të huajt, lëshohet duke mbajtur parasysh nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, ndryshimi i propozuar në pikën 2, të nenit 84, të ligjit, konsiston në ndryshimin e fjalëve "... përpara miratimit të kërkesës së të huajit për plotësimin e një vendi të lirë pune ...", në "... përpara miratimit të kërkesës për leje pune për një shtetas të huaj ...". Ndryshimi është në përputhje me frymën e projektligjit, që synon që periudha e verifikimit nëse vendi i lirë i punës plotësohet apo jo nga kandidatët e përcaktuar në pikën 2, të nenit 84 të përfshihet në periudhën e shqyrtimit të aplikimit për leje pune. Formulimi i pikës 2, të nenit 84, të ligjit 108/2013, i ndryshuar, e bën të paqartë se çfarë miraton autoriteti përgjegjës për punësimin, miraton lëshimin e lejes së punës apo miraton të drejtën për të bërë kërkesë për leje pune.

Periudha e publikimit të vendit të lirë të punës nga “një periudhë të paktën katërjavore”, propozohet në një periudhë prej “7 ditëve kalendarike”, duke ndryshuar autoritetin që bën publikimin e vendit të lirë të punës. Projektligji përcakton që kjo të bëhet vetëm nga autoriteti përgjegjës për punësimin, dhe jo edhe nga punëdhënësi. Punëdhënësi, në këtë rast, duhet të ndjekë vetë procedurën e publikimit të vendit vakant të punës disa herë edhe në specialistë të ndryshëm të zyrës së punës dhe pas mbarimit të periudhës katër javore të aplikojë sërish tek një specialist për leje pune. Tashmë ai aplikon për leje pune duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në aktet nënligjore dhe është specialisti i migracionit që komunikon me specialistë të tjerë për shpalljen e vendit të lirë të punës. Gjithë procedura është brenda aplikimit për leje pune. Në projektligj, shpallja për plotësimin e një vendi të lirë pune i caktohet autoritetit shtetëror përgjegjës për punësimin dhe fillon nga momenti i regjistrimit të kërkesës për leje pune, duke qenë se këto dy procese janë të lidhura me këtë ndryshim, qytetari nuk komunikon me dy specialistë të ndryshëm në rastin më të mirë apo dy zyra të ndryshme brenda autoritetit të punësimit, por komunikon vetëm me specialistin e migracionit, i cili menjëherë pas regjistrimit të kërkesës së shtetasit të huaj bën dhe shpalljen e vendit të lirë të punës.

Gjithashtu, bashkohen edhe afatet kohore të periudhës së publikimit të vendit vakant të punës, tashmë brenda periudhës së shqyrtimit të kërkesës për leje pune.

Në nenin 13, të projektligjit, është shtuar si kategori, që gëzon përparësi në lëshimin e lejes së punës, krahas kategorive të listuara në këtë nen edhe kategoria e punonjësve të teknologjisë së informacionit, shtetas të huaj, me cilësinë e punëmarrësit apo të vetëpunësuarit në fushën e teknologjisë së informacionit, në Republikën e Shqipërisë, sipas rregullave të posaçme që parashikohen nga legjislacioni që rregullon punësimin, që përfitojnë shpërblim për punën e kryer në fushën e teknologjisë së informacionit. Pëfshirja e kësaj kategorie punonjësish të huaj në projektligj është bërë me qëllim dhënien e përparësisë në lëshimin e lejes së punës së kësaj kategorie punonjësish, për të mundësuar dhe lehtësuar aksesin e tyre në tregun e punës në vend, nisur nga nevojat në rritje për punonjës së kësaj fushe.

Në nenin 14, të projektligjit është ndryshuar pika 1, e nenit 87, e ligjit në fuqi, ku përcaktohet se “Të huajit me qëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë i jepet leje pune si punëmarrës nëse pozicioni i punës që i ofrohet në rajonin gjeografik, ku punëdhënësi i tij ushtron veprimtarinë ekonomike, nuk mund të plotësohet nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të nenit 84 të këtij ligji”, me qëllim harmonizimin me ndryshimet e bëra nëpërmjet këtij projektligji, pasi pika 4, e nenit 71, ku referohej kjo dispozitë, është propozuar të shfuqizohet.

Në nenin 15 parashikohet hyrja në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në lidhje me efektet financiare të këtij projektligji, sqarojmë se referuar kontratës me objekt “Marrja e vizës *on-line*”, vlerat përkatëse janë:

Implementimi: 89 400 000 lekë, pa TVSH;

Mirëmbajtja 4 vjeçare: 57 600 000 lekë, pa TVSH.

KËSHILLI I MINISTRAVE